



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. _____

Tiranë ___/___/2022

VENDIM

Nr. 33, datë 31.10.2022

PËR
MIRATIMIN E SHPËRBLIMIT SUPLEMENTAR PËR PERFORMANCË TË
Z. GENCI MAMANI, DREJTOR I PËRGJITHSHËM
I AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE,
PËR PERIUDHËN 1 PRILL 2022 – 30 SHTATOR 2022.

Në bazë dhe në zbatim të nenit 53, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 9, pika 9.4 të Udhëzimit “Për nivelin dhe strukturën e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve, të Drejtorit të Përgjithshëm dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Urdhër të Guvernatorit nr. 1926 prot, datë 25.9.2013, të ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “m” të Statutit të Agjencisë, të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 12, pika 12.9 të Kontratës menaxheriale (të punës) të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 14, datë 30.04.2015, si dhe të vlerësimit të performancës në punë të Drejtorit të Përgjithshëm për periudhën e vlerësimit 1 Prill 2022 – 30 Shtator 2022, Këshilli Drejtues, me propozim të Kryetarit të Këshillit Drejtues,

V E N D O S I:

1. Të miratojë shpërblimin suplementar për performancë të Z. Genci Mamani, Drejtor i Përgjithshëm për periudhën 1 Prill 2022 – 30 Shtator 2022, sipas formularit për vlerësimin e performancës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sektori i Financës dhe Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Donald Duraj

Shqipe Malaj

Kryetar

Sekretare

